



Pranuar / Dorezuar Prilapjen/Prifato Received/Delivered	16.06.2021	1	viti god year
Organ /Rjesht Organ /Jedimca Org./Unit	Nr Prot In Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHICK	3138/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.300/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari - kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar, si dhe Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.300/2021, të datës 23.04.2021, të ankuesit të cilin me autorizim e përfaqëson Av. me adresë banimi rr. "Garibaldi", S2, Hyrja 2, nr.9, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "pezullim parandalues", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datën 16.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.1-118-2387, i datës 03.03.2021, i Kryetarit të Komunës së Lipjanit.

II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Lipjanit që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të ndërmarr të gjitha veprimet për rishqyrtimin e rastit të ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh të gjeturat dhe konstatimet e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikën II të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Lipjanit, sipas Akt emërimit me numër Nr.1-111-45631 të datës 18.08.2016, në pozitën "Inspektor i Tokës bujqësore",

në Drejtoratin për Inspektorat në Komunën e Lipjanit, me datën 03.03.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit ka nxjerrë vendimin me numër Nr.1-118-12387, me të cilin e ka pezulluar nga puna ankuesin nga data 01.03.2021, pas informimit të datës 03.03.2021 me numër Nr.1-404-12309 nga Drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion DPP-Prishtinë, për rastin e evidentuar me numër 2021-KE-43, për arrest nën dyshimin e arsyeshëm se ankuesi me veprimet e tij ka kryer veprën penale "dhënie të ryshfetit".

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 1-118-12387, te datës 03.03.2021 për pezullim të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, përmes përfaqësuesit ligjor të tij Av.

me datën 21.04.2021, përmes Postës së Kosovës, ka dorëzuar ankesën me numër të protokollit 1985/2021, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datën 23.04.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datën 29.04.2021 me numër protokollit 2082/2021, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankese tek Komuna e Lipjanit, ndërsa me datën 20.05.2021 me numër protokollit 2493/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankese nga Komuna e Lipjanit, me shkresat e bashkangjitura.

Me datën 02.06.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes kërkesës zyrtare e dërguar përmes E-mailit zyrtar, ka kërkuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, respektivisht Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, informata zyrtare në lidhje me atë se : *A ka nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve Prokurori i çështjes –Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë ndaj ankuesit z. Pajtim Krasniqi, nëpunës civil në Komunën e Lipjanit, respektivisht "Inspektor i Tokës Bujqësore".*

Me datën 03.06.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar me numër të protokollit 2853/2021 nga Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka pranuar këtë njoftim zyrtar: *"Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda ka nxjerr Aktvendim mbi zgjerimin e hetimeve me numër të lëndës PP/I nr.8K/21 të datës 10.02.2021, kundër të pandehurit*

për shkak të dyshimit të kryerjes se veprës penale „Dhënie e ryshfetit“ nga neni 422 i KPKK-së”, si dhe ju njoftojmë se të njëjtit iu është caktuar masa e paraburgimit dhe ende vazhdon të jetë në këtë masë deri me datë 24.07.2021“.

Po ashtu me datën 02.06.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes kërkesës zyrtare, e dërguar përmes E-mailit zyrtar, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, respektivisht Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, informata zyrtare në lidhje me atë se : *Ndaj z. nëpunës civil në Komunën e Lipjanit „në pozitën "Inspektor i tokës bujqësore", Gjyqtari i Procedurës Paraprake-Gjyqtari i çështjes –Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë a ka nxjerrë aktvendim për caktim të ndonjë mase, (pas kërkesës së Prokurorit për caktim të paraburgimit) lidhur me veprën penale të dyshuar „Dhënie e ryshfetit“ nga neni 422 i KPKK-së?.*

Me datën 03.06.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar me numër të protokollit 2872/2021, nga Ndihmës Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka pranuar këtë njoftim zyrtar: *"Përkitazi me kërkesën tuaj ju njoftojmë se të pandehurit i është vazhduar masa e paraburgimit, në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, ashtu që sipas këtij aktvendimi të pandehurit në fjalë Pajtim Krasniqi, paraburgimi do t'iu zgjas deri me datën 24.07.2021, ora 10:00"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit me numër të protokollit 1985/2021, e datës 23.04.2021, e parashtruar ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i datës 26.02.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 29.04.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 20.05.2021; Përgjigja në ankesë e datës 20.05.2021, nga Komuna e Lipjanit me shkresat e bashkangjitura; Akt emërim i ankuesit me numër Nr.1-111-45631 i datës 18.08.2016; Përshkrimi i detyrave të punës se ankuesit i datës 09.10.2012; Vendim për pezullim i datës 03.03.2021 me numër Nr.1-118/12387; Shkresë zyrtare-informim i datës 03.03.2021 nga Drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit; E-maili zyrtar i datës 02.06.2021; E-maili zyrtar i datës 02.05.2021; Vendimi me numër VK.nr.26/2021 i datës 04.06.2021 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës me numër A.nr.300/2021 të datës 23.04.2021, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit duhet të kthehet në *rishqyrtim* sepse:

Pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Lipjanit me datën 03.03.2021, ka nxjerr Vendim me numër të protokollit Nr.1-118-12387, me të cilit nëpunësin civil i punësuar në pozitën "Inspektor i Tokës Bujqësore", në Drejtoratin për Inspektorat, në Komunën e Lipjanit e ka pezulluar nga puna, pas informimit të datës 03.03.2021 me Nr.1-404-12309, nga Drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion DPP-Prishtinë, për arsye të arrestimit nën dyshimin e arsyeshëm se me veprimet e tij ka kryer vepër penale "dhënie e rryshfetit". Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ky vendim nuk është nxjerr në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht me nenin 56 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sepse në mënyrë taksative janë përcaktuar rastet kur një nëpunës civil pezullohet nga marrëdhënia e punës, sipas detyrës zyrtare.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Kryetari i Komunës së Lipjanit me Vendimin me numër protokollit Nr.1-118-12387 të datës 03.03.2021, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore pezullimin nga detyra pa pagese në pagë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.4 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në të cilin thuhet se: *"1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: „1. në rastin e*

procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji” dhe 1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi”, e që në rastin konkret në bazë të informatës zyrtare nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamentit për Krime të Rënda, konstatohet që nuk ka asnjë vendim nga Gjykata si masë parandaluese për pezullimin e ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Kryetari i Komunës së Lipjanit me Vendimin me numër protokolli Nr.1-118-12387 të datës 03.03.2021, me tw cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore pezullimin nga detyra pa pagese në pagë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me te cilin përcaktohet se: *„... komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”* sepse në rastin konkret vetëm Komisioni Disiplinor mund të pezulloj nëpunësin civil për shkelje të detyrave të punës .

Meqenëse rasti i ankuesit Pajtim Krasniqi është në procedurë penale, atëherë sipas nenit 85 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, thuhet që: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”,* e në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se pas rishqyrtimit te rastit te ankuesit pezullimin e marrëdhënies së punës se ankuesit mund ta bëjë Komisioni Disiplinor ashtu siç parashihet me nenin 48 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *“Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”,* respektivisht, Komisioni disiplinor për nëpunësit civilë në Komunën e Lipjanit , duhet të konstatoje saktë dhe duke u mbështetur me fakte shkeljet eventuale, arsyet në rast se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga ankuesi e pengon hetimin disiplinor apo jo, dhe mbi bazën e konstatimeve të nxjerr vendim duke u bazuar në nenin 48, 49 dhe 50 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni disiplinor duhet të aplikojë nenin 11, 12 dhe 13 të Rregullores Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesën e Zyrtareve Publike, respektivisht pas rishqyrtimit Komisioni disiplinor mund te vendose edhe për *„pezullimin nga marrëdhënia e punës”* të nëpunësit civil, sipas nenit 13 paragrafit 6 të Rregullores Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.300/2021**

Ardita Perçuku-Shyti

Ardita Perçuku-Shyti
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi-Bajraktari
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Av. Behar Ejupi, përfaqësues i autorizuar i ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

